



Gradjanska Inisciativa "Srpska"
(SRPSKA LISTA)

Raportet financiare të fushatës dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune - Graçanicë
12 Janar 2015 – 16 Janar 2015



Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Shënimet e pasqyrave financiare.....	8-11

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë se Gragjanska Iniciativa "Srpska"

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i Opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për te audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik **Gradjanska Iniciativa "Srpska"** (në vijim referuar si "Srpska"), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 12 Janar 2015, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën 12 Janar 2015 deri më 16 Janar 2015, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faqe 6-11.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të subjektit Gradjanska Iniciativa "Srpska". Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim të Opinionit

- Siç paraqitet në shënimin 3 të Pasqyrave financiare, - Shpenzimet, Subjekti Politik ka deklaruar shpenzime për Raportin e Fushatës ne vlerë 3,295.00 EUR për periudhën 12 Janar 2015 deri më 16 Janar 2015, në mungese te dokumenteve mbështetëse ne nuk ishim ne gjendje te konstatojmë saktësinë e shpenzimeve te prezantuar në vlerë 3,295.00 Euro.
- Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që SP ka pranuar donacione në të holla përmes arkës ne vlere 3,295.00 EUR për periudhën 12 Janar 2015 deri më 16 Janar 2015 në kundërshtim me kërkesat ligjore te ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 5 Kontributet për subjektet politike, i cili lejon pranimin e donacioneve ne te holla vetëm përmes transaksionit bankar.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore ne lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe te fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e drejtuesve dhe e atyre të ngarkuar me udhëheqjen e SP për Pasqyrat Financiare

Drejtuesit e Subjektit politik janë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpалosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse drejtimi synon të likuideojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të SP-së.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Besa Berisha
Auditor ligjor
08 Dhjetor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare			
Me datën:16 Janar 2015			
Pasuritë	Shënime	Bilanci ne fund te periudhës	Bilanci ne fillim te periudhës
Pasuritë afatgjata			
Toka, objektet dhe pajisjet			
Pasuritë e paprekshme			
Pasurit tjera afatgjate			
Gjithsej pasurit afatgjate			
Pasurit afatshkurta		0.00	0.00
Llogarite e arkëtueshme			
Parapagimet		0.00	0.00
Paraja dhe ekuivalentet e parasë		0.00	0.00
Pasurit tjera afatshkurta		0.00	0.00
Gjithsej pasurit tjera afatshkurta		0.00	0.00
Gjithsej pasuritë		0.00	0.00
Ekuiteti			
Fonde te akumuluar		0.00	0.00
Suficiti / (deficiti) I vitit		0.00	0.00
Gjithsej Ekuiteti		0.00	0.00
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huate e pagueshme			
Te hyrat e shtyra			
Gjithsej Detyrimet afatgjata		0.00	0.00
Detyrimet afatshkurta		0.00	0.00
Llogarite e pagueshme dhe te tjera		0.00	0.00
Huate e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurta			
Gjithsej detyrimet afatshkurta		0.00	0.00
Gjithsej detyrimet		0.00	0.00
GJITHESEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		0.00	0.00

Pasqyra e të ardhurave dhe Shpenzimeve		
Për periudhën: 12/01 / 2015 deri 16 / 01 / 2015		
	Shënimi	Vlera në Euro
Te hyrat		
Te hyrat nga buxheti		
Te hyrat nga anëtarësia		
Donacionet dhe kontributet ne te holla	2	3,295.00
Kontributet ne natyre ne mall dhe shërbime		
Te hyrat e tjera		
Gjithsej te hyrat për periudhën		3,295.00
Shpenzimet		
Pagat dhe kompensimet	3	0.00
Shpenzimet e transportit	3	257.52
Reklama, reprezentacioni dhe konferencat	3	2,912.48
Blerja e mallrave	3	0.00
Shpenzimet e përgjithshme	3	125.00
Shpenzimet e ndryshme	3	0.00
Gjithsej shpenzimet për periudhën		3,295.00
SUFICITI / (DEFICITI) për periudhën		0.00

Srpska Lista

Pasqyrat Financiare të Fushatës 12 Janar 2015 deri më 16 Janar, 2015

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune Graçanicë

1. Informata te përgjithshme

Subjekti politik : Lista Serbe (Srpska Lista – GISL)

Udhëheqja: Vladeta Kostic (Kryetar i partisë)

Themelues: Vladeta Kostic

Përfaqësues financiar: Sergjan Petkovic

Pasqyrat financiare te Srpska Lista janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën TEB

.

Srpska Lista

Pasqyrat Financiare të Fushatës 12 Janar 2015 deri më 16 Janar, 2015

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune Graçanicë

Shënimi 2: Donacionet dhe kontributet ne te holla

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera ne Euro	E pranuar përmes	
Kontribuesi	Adresa	Numri Personal			Banke	Arke
VladetaKosric	Suvi Do Gracanica		22.12.2014	300.00		300.00
LubinkoKaradjic	LapleSeloGracanica		23.12.2014	200.00		200.00
NebosaMilovanovic	Gusterica- Gracanica		25.12.2014	200.00		200.00
ZoranDanilovic	Susica- Gracanica		25.12.2014	200.00		200.00
DejanJovanovic	Gracanica		25.12.2014	200.00		200.00
IvicaMicic	Gracanica		25.12.2014	200.00		200.00
MirjanaZivic	LapleSeloGracanica		80.01.2015	100.00		100.00
Milan Jovanovic	Gracanica		08.01.2015	100.00		100.00
Ivan Tomic	LapleSeloGracanica		08.01.2015	100.00		100.00
PredragKapetanovic	Gusterica- Gracanica		19.01.2015	100.00		100.00
NebojsaMaksimovic	Gracanica		09.01.2015	100.00		100.00
SreckoCvijic	Lepina -Gracanica		09.01.2015	100.00		100.00
IvicaDimic	Lepina -Gracanica		09.01.2015	100.00		100.00
AleksandarTomic	LapleSeloGracanica		09.01.2015	100.00		100.00
SinisaSimonovic	Batuse- Gracanica		12.01.2015	100.00		100.00
Ivan Micic	Gracanica		12.01.2015	100.00		100.00
MiroslavPopovic	Gracanica		12.01.015	100.00		100.00
ZoranMitrovic	Gusterica- Gracanica		12.01.2015	100.00		100.00
BogoljuIvic	Gracanica		12.01.2015	100.00		100.00
SnezanaJovanovic	Gracanica		12.01.2015	100.00		100.00
LiljanaKapetanovic	Gracanica		12.01.2015	100.00		100.00
JelenaTrajkovic	Gracanica		14.01.2015	100.00		100.00
Stefan Aleksic	Gracanica		14.01.2015	100.00		100.00
StevanDjordjevic	Gracanica		15.01.2015	100.00		100.00
DusanArsic	Gracanica		15.01.2015	100.00		100.00
MiljanRadic	Lepina -Gracanica		15.01.2015	95.00		95.00
Gjithsej donacionet dhe kontributet ne te holla :				3,295.00		3,295.00

Shënimi 3 . Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi ne Euro	Pagesa ne Euro	Borxhi i mbetur ne Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto			
Pagat vëzhguesve			
Kontributi pensional nga punëmarrësi			
Kontributi pensional nga punëdhënësi			
Tatimi ne te ardhura personale			
Benificionet te tjera			
Gjithsej pagat dhe kompensimet	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike te huazuara			
Karburantet	257.52	257.52	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusi,trenit,taxi etj			
Sigurimi dhe mirëmbajta e veturave			
Çdo sigurim tjetër transporti			
Gjithsej shpenzimet e transportit	257.52	257.52	0.00
Reklama, reprezentacioni dhe konferencat			
Hapësirë lokale, zyra dhe objekte tjera me qira			
Ushqimi	491.00	491.00	0.00
Aktivitetet kulturore dhe rekreative	0.00	0.00	0.00
Radio dhe spote televizive	671.48	671.48	
Stenda e afishimi dhe reklamimet ne gazeta	870.00	870.00	0.00
Shpenzimet e tjera reklama, reprezentacioni dhe konferencat	880.00	880.00	0.00
Gjithsej reklama, reprezentacioni dhe konferencat	2,912.48	2,912.48	0.00

Srpska Lista

Pasqyrat Financiare të Fushatës 12 Janar 2015 deri më 16 Janar, 2015

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune Graçanicë

Blerja e mallrave			
Furnizime ne zyre	0.00	0.00	0.00
Pajisjet e vogla	0.00	0.00	0.00
Gjithsej blerja e mallrave	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Telefoni, interneti dhe posta	125.00	125.00	0.00
Rryma, shërbimet komunale(uji dhe mbeturinat)			
Gjobat dhe ndëshkimet			
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyre ne mallra dhe shërbime			
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	125.00	125.00	0.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajta e pajisjeve dhe hapësira e zyrave			
Shpenzimet qe nuk janë përfshi ne asnjë kategori tjetër	0.00	0.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	0.00	0.0	0.00
Gjithsej shpenzimet	3,295.00	3,295.00	0.00